



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.85/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Nenad Lazic dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Kastriot Krosa nga Zvicra, paraqitur kundër vendimit me nr.1762/2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si i bazuar apeli i Kastriot Krosa nga Zvicra, **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me nr.1762/2017 i datës 22.09.2017, përkitazi me votuesin Kastriot Krosa. **URDHËROHET** KQZ-ja të përfshijë votuesin Kastriot Krosa me vendbanim Rue de Geneve, 75, 1004 Lausanne (Zvicër), në listat e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Kastriot Krosa nga Zvicra, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 14.09.2017 në të cilën pretendohet se nuk figuron në Listën e Votuesve të shpallur nga KQZ-ja, për votim jashtë vendit, pasi që KQZ-ja e ka refuzuar aplikacionin e tij që të përfshihet në listat e votuesve jashtë Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 27.09.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka filluar me 16.07.2017 dhe ka mbaruar me 23.08.2017, ndërsa lista votuese për zgjedhjet lokale 2017, është certifikuar me datën 22.09.2017, me vendimin 1762/2017. Apeluesi Kastriot Krosa ka aplikuar për votim jashtë Kosovës, ku KQZ-ja i ka refuzuar aplikacionin për shkak se dosja ka qenë e pa kompletuar për faktin se dokumentet e identifikimit janë me afat të skaduar, dhe se nuk ka dëshmuar se ka të drejtë të përfshihet në listën votuese jashtë Kosovës pasi që aplikacioni ka qenë i pa nënshkruar.

PZAP-i pas që shqyrtoj apelin vlerësoj se :

Apeli është i bazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkëngjitur dokumentin valid - lejen e njoftimit Nr.1173454119, të datës 13.08.2014, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. Prandaj Paneli, ka konstatuar se apeli ka mbështetje ligjore në nenin 3.1, pika a), e Rregullës Zgjedhore nr.03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedhë fletëvotimin për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë rregull të zgjedhjeve”*, pasi që në rastin konkret parashtruesi i apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 85/2017 më datën 28.09.2017.

Kryesues e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*